

P. nr.52/18

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.P. nga fsh. M.K Gj., për shkak të veprës penale vjedhje nga neni 325/1 të KPRK-së ,sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP.nr.1222/17 të datës 26.01.2018, në shqyrtimin fillestar , të mbajtur më datë **23.08.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Enis Gashi dhe te akuzuarit , mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **E.P.** nga fsh. M.K Gj., i biri i G. dhe i nënës L. e gjinisë M., data e lindjes .... në Gj., ka te kryer shkollën fillore , i pa punë , i gjendjes se dobët ekonomike, shqiptar , shtetas i R. Kosovës , me nr. ID .....

**Ë s h t ë f a j t o r :****Sepse:**

**-me dt. 11.08.2017, rreth orës 04.02 min ,në Gj., në Rr" F.S.N.",** me qëllim përvetësimi te kundërligjshëm për veti apo për tjetrin ,i merr pasurin e luajtshme tjetrit, të dëmtuarit Kuvendit Komunal Gj.,ashtu qe shkon me automjetin me targa te regj.... te sheshi "A.P."kinemaja verore afër Kryqit të Kuq ,e kur afër kioskut verën frigoriferin me mbishkrim "... " e vjedh ne atë mënyre qe frigoriferin e ngarkon ne gepekun e automjetit dhe e dërgon te shtëpia e tij ne fshatin M.K Gj. ,e pas nxjerrjes se kamerave te sigurisë hetohet dhe vërtetohet se e ka vjedhur frigoriferin i cili sekuestrohet dhe i kthehet te dëmtuarit.

**-me çka ka kryer veprën penale te vjedhjes nga neni 325/1 te KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,17,41,46,49,50,51, 52.5,73 ,neni 325/1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

**DENIM ME KUSHT**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1(një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe dënim me gjobë ne shume prej **200 (dyqind )euro** , të cilin shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh , pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë .

Nëse dënimi me gjobë nuk mund te ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së ,atëherë i njëjti do t'i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **10 (dhjetë ) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**

I dëmtuari Kuvendi Komunal ne Gjakove për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë ne emër te e paushallit gjyqësor shumen prej **30,00.-€**, në afat prej **15 ditësh**, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP.nr.1222/17 të datës 26.01.2018, kundër të akuzuarit E.P.nga fsh.M.K Gj.për shkak te veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të datë 23.08.2018, Prokurori i shtetit Enis Gashi , lexojë aktakuzën PP.nr. 1222/17 të datës 26.01.2018 dhe deklaroi se mbetet në tërësi pranë Aktakuzës,

I akuzuari E.P., lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, me pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës jam penduar për veprën e kryer për shkak të kushteve ekonomike, kërkoj falje nga e dëmtuara për dëmin e shkaktuar edhe pse frigoriferi i vjedhur është sekuestruar dhe kthyer të dëmtuarës, premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, gjendjen e dobët ekonomike te me shqiptojë një dënim me te butë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit prokurori i shtetit Enis Gashi. deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova te mjaftueshme .

Ne shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari E.P. **-me dt. 11.08.2017, rreth orës 04.02 min ,në Gj., në Rr" F. S. N."** me qëllim për vetësiguri te kundërligjshëm për veti apo për tjetrin ,i merr pasurin e luajtshme tjetrit, të dëmtuarit Kuvendit Komunal Gjakove, ashtu qe shkon me automjetin me targa te rgj.... te sheshi "A.P." kinemaja verore afër kryqit te kuq ,e kur afër kioskat vëren frigoriferin me mbishkrim "...." e vjedh ne atë mënyrë qe frigoriferin e ngarkon ne gepekun e automjetit dhe e dërgon te shtëpia e tij ne fshatin M. K Gj. ,e pas nxjerrjes se kamerave te sigurisë hetohet dhe vërtetohet se ka vjedhur frigoriferin i cili sekuestruhet dhe i kthehet te dëmtuarit.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimi te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi te fajësisë ,pranimi është bere vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarit formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarin ta shpalle fajtor dhe ta gjykojë ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit te veprës penale te kryer si ne dispozitiv te aktgjykimit ,ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit , pranimin e vullnetshëm të fajësisë në çdo fazë te procedurës , gjendjen e dobët ekonomike, pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , premtimi se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra te tilla ,kërkim falja nga i dëmtuari , kthimi i frigoriferin të dëmtuarit . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënim me burgim në kohëzgjatja prej **3(tre)muajve** i cili dënim

nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** ) nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale si dhe dënim me gjobë ne shume prej **200(dyqind) euro**, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marrë bazuar në nenin 463/2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450/1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P. nr.52/18 më datë 23.08.2018.**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.